



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 245 Akti

Nr. 270 Vendimi
Tiranë, më 3.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 1.6.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Shpresa Beçaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, znj. Shpresa Beçaj, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 1.7.2020 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Shpresa Beçaj, për shkak të mbajtjes së statusit të gjyqtares, është shortuar për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.
2. Në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 15.1.2019, znj. Shpresa Beçaj është shortuar si subjekt rivlerësimi, së bashku me trupin gjykues nr. 3, që do të shqyrtonte këtë subjekt, të përbërë nga komisionerët: Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj.
3. Në datën 24.10.2019, znj. Alma Faskaj është zëvendësuar nga z. Roland Ilia (anëtari zëvendësues i shortuar për këtë trup në datën 15.1.2019), pasi kishte paraqitur dorëheqjen nga kjo çështje dhe pranimit të kësaj dorëheqjeje nga trupa e shortuar për këtë qëllim, me vendim nr.1 të së njëjtës datë.
4. Në vijim të fazës së rivlerësimit u konstatua se Komisioni nuk kishte të administruara nga organet ndihmëse dosjet dhe raportet përkatëse, të parashikuara nga nenet 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk zotërohej asnjë adresë *e-mail*-i për të kontaktuar me znj. Shpresa Beçaj.
5. Në këto kushte, Komisioni kërkoi informacion lidhur me këtë situatë dhe specifikisht mbi paraqitjen e deklarimeve në KLD/KLGJ, DSIK dhe ILDKPKI, në zbatim të neneve të sipërcituara, si dhe i dërgoi një pyetësor znj. Shpresa Beçaj (sapo mori dijeni mbi adresën funksionale të *e-mail*-it).
6. Me shkresën e datës 17.2.2020², DSIK-ja i ka bërë me dije Komisionit se: “[...] znj. Shpresa Beçaj, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nuk ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”.
7. Me shkresën e datës 24.2.2020, nr. *** prot., Këshilli i Lartë Gjyqësor i komunikoi Komisionit se nga të dhënat e regjistrit të posaçëm të administruar nga KLD-ja³ (aktualisht pranë KLGJ-së), nuk rezultoi që në periudhën përkatëse 21.10.2016 – 31.3.2017, sipas parashikimeve ligjore, të jenë depozituar formularë dhe dokumentacion shoqëruar për vlerësimin profesional nga znj. Shpresa Beçaj. Gjithashtu, në përgjigjen e saj, KLGJ-ja bëri një përmbledhje të karrierës së znj. Shpresa Beçaj⁴ dhe duke cituar dispozitat ligjore të aplikueshme në këtë rast, lidhur me statusin e saj, specifikoi se znj. Shpresa Beçaj në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 nuk ishte një gjyqtare në ushtrim të detyrës.

¹ Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar si “ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “*Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio*”.

² Kjo shkresë është e klasifikuar “sekret”.

³ Kopja e këtij regjistri i është bashkëngjitur përgjigjes së KLGJ-së së bashku me dokumente të tjera.

⁴ Duke vënë në dispozicion të Komisionit dy vendime të Gjykatës Administrative (të të dy shkallëve), lidhur me rrimërimin e saj.

8. Me e-mail-in e datës 2.2.2020, znj. Shpresa Beçaj, duke iu përgjigjur pyetjes së nisur nga Komisioni - pasi ka paraqitur një përmbledhje kronologjike të karrierës dhe ka përshkruar hapat gjyqësorë që i janë dashur të ndërmarrë për të realizuar konkretisht riemërimin si gjyqtare, i cili i takonte *ex lege*, pas mbarimit të mandatit në Gjykatën e Lartë ka sqaruar, sa vijon:
- a. *“[...] unë jam gjyqtare karriere prej vitit 1987 dhe fakti që më kishte mbaruar mandati i anëtarit të Gjykatës së Lartë nuk presupozonte se unë nuk mund ta ushtroja përsëri detyrën e gjyqtarit me përjashtim të rastit të arritjes së moshës së pensionit (por që nuk është ky rasti). Që nga momenti i paraqitjes së kërkesës sime, KLD-ja kishte detyrimin ligjor, siç parashikonte neni 25 i ligjit organik i Gjykatës së Lartë (ligji nr. 8588/2000), të shqyrtonte kërkesën dhe të më emëronte në Gjykatën e Apelit Tiranë. Fakti që KLD-ja nuk mori në konsideratë dhe nuk e shqyrtoi prej rreth 5 (pesë) vjetësh kërkesën time për të më riemëruar në Gjykatën e Apelit përbënte cenim flagrant të të drejtave të mia të fituara për sa i përket statusit.*
 - b. *Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë është pjesë e sistemit gjyqësor dhe fakti i emërimit të një gjyqtari karriere (siç isha unë) në këtë gjykatë, nuk përbënte dhe as nuk konsiderohej si shpëputje nga sistemi gjyqësor.*
 - c. *Në këtë kuptim, gjyqtarit që ka fituar njëherë statusin, nuk mund t'i cenohet ose hiqet ky status përveçse në raste rigorozisht të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligj.*
 - d. *Sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor të kohës, unë përfundova ushtrimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë, detyrë kjo që ushtrohej për një kohë të caktuar (9 vjet), por kjo nuk nënkuptonte se unë kisha përfunduar karrierën time profesionale si gjyqtare në sistemin gjyqësor, duke qenë se e kisha fituar statusin e gjyqtarit.*
 - e. *Nisur nga fakti se KLD-ja nuk shqyrtoi për më shumë se 3 (tre) vjet kërkesën time dhe nuk po ndërmerrte veprimet ligjore të detyrueshme për riemërimin tim në detyrën e gjyqtares së Apelit dhe kjo situatë po cenonte të drejtat e mia ligjore, iu drejtova me padi Gjykatës Administrative, me objekt ‘rehabilitim i statusit të gjyqtarit në karrierë dhe shpërbllim dëmi’. Gjykata Administrative e Shkallës Parë Tiranë (vendimi nr. ***, datë 26.7.2016) ka konstatuar faktin e mosveprimit me faj të KLD-së në lidhje me kërkesën e depozituar në datën 10.10.2013, të cilën KLD-ja, pa shkak të përligjur, nuk e ka marrë në shqyrtim. Kjo gjykatë ka çmuar se mosveprimi i KLD-së për trajtimin e kërkesës sime sipas nenit 25 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, më ka shkaktuar dëm moral dhe ekzistencial.*
 - f. *Gjykata Administrative e Apelit (vendimi nr. ***, datë 5.4.2017) e ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Shkallës së Parë Tiranë duke pranuar padinë time, duke konfirmuar kështu saktësinë e qëndrimit tim për sa i përket statusit tim profesional, si dhe duke vendosur përfitimin e pagës që unë duhej të merrja si gjyqtare e Gjykatës së Apelit përgjatë gjithë kësaj kohe (43 paga mujore). Në këto kushte, KLD-ja u detyrua që të më rikthejë në sistemin gjyqësor, duke më riemëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë (gjykata në të cilën kisha ushtruar detyrën përpara se të emërohesh në Gjykatën e Lartë) dhe ku në datën 4.6.2018 kam filluar rregullisht ushtrimin e detyrës, duke*

dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 4.7.2018 deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës.

- g. *Siç e theksova edhe më lart, statusi im profesional në kohën e fillimit të zbatimit të ligjit të rivlerësimit të magistratëve, për arsye objektive nuk ishte i qartë. Në aspektin personal (subjektiv) unë e kam konsideruar personin tim si gjyqtar, status të cilin ma garantonte ligji i kohës, sepse nuk kam pasur asnjëherë shkëputje nga ky status. Nuk ka pasur asnjëherë ndonjë akt të marrë nga organi kompetent që të deklaronte të përfunduar statusin tim si gjyqtar, qoftë në formën e shkarkimit nga detyra si masë disiplinore apo të lirimit nga detyra për shkak dorëheqjeje, plotësimi të moshës së pensionit, paaftësisë fizike etj. Ndërsa në aspektin objektiv, unë nuk isha 'gjyqtare në detyrë', duke qenë se nuk e ushtroja realisht detyrën e gjyqtares. Shkëputja nga ushtrimi i detyrës erdhi si pasojë e veprimeve arbitrare të KLD-së, e cila nuk shqyrtonte kërkesën time për të më riemëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë.*
- h. *Duke e konsideruar në aspektin personal 'subjektiv' personin tim si gjyqtar, në momentin kur ligji nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' ka hyrë në fuqi datë 7.10.2016 dhe ka filluar të zbatohet, unë jam paraqitur personalisht pranë ILDKPKI-së për plotësimin dhe dorëzimin e tri formularëve sipas ligjit, por kam marrë përgjigje se nuk isha pjesë e subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji pasi në rakordimin me listat përkatëse të dorëzuara nga institucionet, emri im nuk figuronte në to.*
- i. *Pas mbarimit të mandatit dhe pas përfundimit të pagesës kalimtare prej 3 vjetësh, të cilën e përfitoja si rezultat i statusit institucional që gëzoja, unë u detyrova që për të siguruar të ardhura, të ushtroja detyrën e avokatit duke filluar që nga koha që isha në pritje të shqyrtimit të kërkesës për riemërim nga KLD-ja dhe shqyrtimit të padisë nga Gjykata Administrative (nga viti 2016 deri në vitin 2018). Fakti që unë nuk kam qenë gjyqtare në detyrë në këtë periudhë e vërtetoj së pari me dokumentin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, ku tregohet se kam punuar në firmën ligjore '***', aktivitet të cilin e kam pezulluar në datën 18 maj 2017. Së dyti, në këtë periudhë unë nuk figuroja në organikën e asnjë gjykate të vendit (dhe nuk ka se si të jetë ndryshe për faktin se funksioni i gjyqtarit në detyrë është ligjërish i papajtueshëm me ushtrimin e njëkohshëm të ndonjë profesioni tjetër fitimprurës si p.sh.: avokat, noter, përmbarues, nëpunës publik, etj.). Së treti, gjithashtu, duke qenë se kam konkurruar për t'u emëruar në Organet e Procesit të Vlerësimit të magistratëve (KPK dhe KPA), një ndër kriteret për t'u zgjedhur ishte edhe kriteri i përcaktuar në germën 'ë', pika 1, e nenit 6, të ligjit nr. 84/2016⁵, kriter i cili është konsideruar si i plotësuar, bazuar në filtrimin që i bënë kandidatëve institucionet përgjegjëse për ngritjen e organeve të vlerësimit të magistratëve.*
- j. *Për efekt të ligjit të procesit të rivlerësimit të magistratëve, në kohën e fillimit të zbatimit të tij, unë 'nuk kam qenë gjyqtare në detyrë', pra, nuk kam qenë subjekt i rivlerësimit dhe në këtë aspekt nuk kam pasur të drejtën për të plotësuar dhe dërguar formularët në organet përkatëse shtetërore të ngarkuara me zbatimin e tij. Konfirmimin si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë unë e kam marrë, siç thashë më*

⁵Neni 6/1/ë nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit.

sipër, shumë më vonë se fillimi i zbatimit të efekteve të ligjit për procesin e vlerësimit të magistratëve. Gjithashtu, unë as 'nuk mund të konsiderohem si ish-gjyqtare' për faktin se pavarësisht se nuk isha gjyqtare në detyrë në këtë periudhë, kisha iniciuar procedime administrative dhe gjyqësore për t'u rehabilituar dhe për t'u riuemëruar në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku m'u konfirmua statusi nga vendimet e Gjykatave Administrative (për arsyet e sipërpërmendura më lart).

- k. *Këto janë arsyet për të cilat unë nuk kam pasur mundësi të plotësoj dhe dorëzoj në kohë formularët që parashikon ligji për procesin e rivlerësimit të magistratëve”.*
9. Gjithashtu, znj. Shpresa Beçaj, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ në lidhje me problematikat e evidentuara më sipër, ka paraqitur në Komision shpjegimet e saj, si dhe dokumentacion mbështetës.
10. Në vijim të hapave hetimorë të ndërmarrë, Komisioni, pasi kishte përcjellë një pyetësor dhe një shkresë në janar të vitit 2020 dhe kishte marrë përgjigjet përkatëse nga znj. Shpresa Beçaj, në datën 6.3.2020, vendosi të mbyllë fazën hetimore, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.
11. Në datën 10.3.2020, trupi gjykues njoftoi znj. Shpresa Beçaj mbi mbylljen e hetimit administrativ në fjalë duke e ftuar të njihej me dosjen dhe të paraqiste shpjegimet e saj, e cila edhe pse fillimisht nuk e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, brenda afatit të përcaktuar, në datën 21.3.2020 ka paraqitur në Komision shpjegimet dhe parashtrimet, të emëruara prej saj “*Shpjegime shtesë*” - pasi ishte shprehur edhe më herët mbi të njëjtat rrethana, në vijim të pyetësorit të nisur nga Komisioni.
12. Komisioni, në datën 28 maj, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ka njoftuar znj. Shpresa Beçaj për caktimin e seancës dëgjimore, të parashikuar për datën 3.6.2020.
13. Në datën 2 qershor, në Komision u paraqit nga përfaqësuesit ligjorë, të emëruar nga subjekti, një raport mjekësor për paaftësi në punë të znj. Shpresa Beçaj, për një periudhë 14-ditore, si dhe një kërkesë për njohjen me dosjen e rivlerësimit.
14. Ndërkohë që në datën 4 qershor, përfaqësuesi i subjektit iu paraqit Komisionit dhe u njoh me përbërjen e dosjes fizike, si dhe tërhoqi një kopje në format elektronik të materialeve të dosjes, në bazë të të cilave trupi gjykues kishte mbërritur në rezultatet e hetimit, të komunikuar më herët subjektit.
15. Në datën 9 qershor anëtarja e trupit gjykues, znj. Suela Zhegu, ka paraqitur dorëheqjen nga rivlerësimi i mëtejshëm i znj. Shpresa Beçaj dhe pas pranimit të kësaj kërkesë nga një trup gjykues tjetër, në datën 15.6.2020 është zëvendësuar nga komisioneri Olsi Komici.
16. Komisioni, në datën 16.6.2020, njoftoi subjektin për zëvendësimin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, duke e ftuar që të shprehej mbi konfliktin e mundshëm të interesit, si dhe për shtyrjen e seancës së caktuar për në datën 17 qershor.
17. Po në pasditen e datës 16 qershor, përfaqësuesi ligjor i subjektit i ka komunikuar Komisionit nëpërmjet *e-mail-it*, se znj. Shpresa Beçaj nuk kishte konflikt interesi me anëtarin e ri, z. Olsi Komici, dhe ka bërë me dije gjithashtu se subjekti nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe ka përcjellë një raport mjekësor tjetër, për 30 ditë paaftësi në punë.

18. Ndërkohë me e-mail-in e datës 17 qershor, znj. Shpresa Beçaj ka konfirmuar personalisht mospasjen e konfliktit të interesit me askënd nga anëtarët e trupit dhe i ka bërë me dije Komisionit se pavarësisht gjendjes jo të mirë shëndetësore ishte në dispozicion për t'u paraqitur në seancën dëgjimore që mund të caktohej kur të çmohej.
19. Në datën 18 qershor, znj. Shpresa Beçaj ka nisur një e-mail tjetër, me të cilin komunikonte se në dosjen elektronike të tërhequr nga përfaqësuesi nuk gjendeshin “Shpjegimet shtesë” të dërguara prej saj në datën 21.3.2020 dhe duke prezumuar e aluduar se ky material nuk gjendej as në dosjen fizike dhe mund të mos ishin njohur me përmbajtjen e tij as trupi dhe/ose vëzhguesi ndërkombëtar, e ka bashkëngjitur atë.
20. Në fakt, “Shpjegimet shtesë” në fjalë, rezulton se i janë shpërndarë dhe bërë me dije anëtarëve të trupit, si dhe vëzhguesit ndërkombëtar në rrugë elektronike, po në datën 21 mars, në të cilën subjekti i rivlerësimit i kishte dërguar. Gjithashtu është konstatuar se ky material gjendej prezent në dosjen fizike dhe gjithsesi nuk bënte pjesë midis atyre dokumenteve mbi të cilat ishin kristalizuar rezultatet e hetimit (që zakonisht u vihen në dispozicion subjekteve përpara se të kenë paraqitur prapësimet e tyre).
21. Në mbledhjen e datës 25.6.2020, trupi gjykues pasi dëgjoi vlerësimin e anëtarit të ri mbi rezultatet e hetimit dhe në vijim të diskutimeve të ndryshme caktoi datën e re për seancën dëgjimore lidhur me këtë çështje për më 1 korrik dhe e riftoi znj. Shpresa Beçaj që të paraqitej për të dhënë argumentet dhe shpjegimet e saj.

II. SEANCA DËGJIMORE

22. Seanca dëgjimore e datës 1.7.2020 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.
23. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ të kryer mbi të tri kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove.
24. Znj. Shpresa Beçaj, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Gjithashtu edhe përfaqësuesi i saj ligjor, pjesëmarrës në këtë seancë, paraqiti mbrojtjen e argumentuar, duke depozituar në sekretarinë gjyqësore dokumente shtesë.
25. Subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe shprehu qëndrimin përfundimtar duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
26. Seanca dëgjimore u ndërpre për të rifilluar në datën 3.7.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

27. Znj. Shpresa Beçaj ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje kur është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës lidhur me shpjegimet e veta.

IV. VLERËSIMI I TRUPIT GJYKUES

28. Trupi gjykues - duke u nisur nga gjendja faktike e pazakontë lidhur me mosparaqitjen e deklaratave të parashikuara nga dispozitat e neneve 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, brenda afateve të përcaktuara, fakt ky i pranuar edhe nga subjekti - konsideron të nevojshëm analizimin paraprak të disa rrethanave, nga vlerësimi i të cilave mund të arrihet në kristalizimin e efekteve dhe pasojave ligjore që rrjedhin pikërisht nga dinamika e veprimeve apo mosveprimeve të subjektit, në raport me detyrimet e sanksionuara në normativat e sipërcituara. Konkretisht, konsiderohet e nevojshme: (i) analiza paraprake e statusit funksional në të cilin gjendej subjekti i rivlerësimit në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016; për të kaluar më pas në (ii) evidentimin e detyrimeve ligjore që kanë rrjedhur nga ky status; dhe më tej nëpërmjet (iii) vlerësimit të përmbushjes ose jo të detyrimeve në fjalë, të gërshetuara këto edhe me hulumtimin mbi (iv) ekzistencën ose jo të shkaqeve të arsyeshme faktiko-ligjore që mund të kenë pamundësuar subjektin për të vepruar në kohë - për të çmuar, në konkluzion, nën dritën e parashikimeve specifike të dispozitave të rangut kushtetues dhe ligjor, lidhur me pasojat e mundshme juridike, që rrjedhin nga faktet që do të rezultojnë të provuara.

Lidhur me statusin funksional

29. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se znj. Shpresa Beçaj - siç është specifikuar edhe më lart - pasi ka përfunduar mandatin si gjyqtare në Gjykatën e Lartë, ka ruajtur në vijimësi statusin e gjyqtarit, ndonëse riemërimi i saj ka rezultuar i vonuar, duke krijuar një shkëputje të vijimësisë së kryerjes së funksionit konkretisht, për sa kohë është kryer në një distancë kohore disavejeçare.
30. Faktin e ruajtjes në vijimësi të statusit të gjyqtares prej largimit nga Gjykata e Lartë e deri në rifillimin e kryerjes së funksionit të gjyqtares në Gjykatën e Apelit Tiranë, e ka pohuar dhe pranuar edhe personalisht znj. Shpresa Beçaj. Gjithashtu, ka rezultuar se në vijim të një procesi gjyqësor të ndërmarrë, lidhur me vonesën e riemërimit ka përfituar edhe një dëmshpërblim, pikërisht, për të gjithë periudhën e mosushtimit të funksionit, për shkak të emërimit të munguar deri në momentin vendimmarrës. Ky fakt, i ndërthurur edhe me pohimet e subjektit, konfirmon se është ndierë dhe është trajtuar edhe financiarisht si një gjyqtare që ka qenë në vijimësi pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor, duke i gëzuar të drejtat që rridhnin ndërkohë, pikërisht nga pasja e statusit të gjyqtarit.
31. Komisioni vlerëson se në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, situata faktiko-ligjore e znj. Shpresa Beçaj, ndonëse përkon me periudhën e moskryerjes konkretisht të funksionit të gjyqtares, për sa kohë ende nuk ishte riemëruar, të çon në përfundimin se gëzonte statusin e gjyqtarit/magjistratit, përfshirë edhe trajtimin financiar përkatës - siç ishte shprehur ndërkohë edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, vërehet se edhe emërimi i znj. Shpresa Beçaj në Gjykatën e Apelit Tiranë, që është konkretizuar pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 është bazuar pikërisht mbi ekzistencën e këtij statusi, të konfirmuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, me vendim të formës së prerë - përpos faktit se ky emërim jo vetëm që ka qenë tejet i vonuar, por duket sikur është kryer në kapërcim të kompetencave të KLD-së, për sa kohë këto të fundit

rezultonin të pezulluara nga dispozitat tranzitore që kishin hyrë në fuqi përpara emërimit në fjalë. Lidhur me faktin që, për subjektet që gëzojnë *ipso jure* statusin e magjistratit, mosushtrimi i detyrës nuk përbën shkak për përjashtimin e tyre nga procesi i rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit – (Vendimi nr. 2/2020, par. 16.3).

Lidhur me detyrimet që ka passjellë pasja e statusit të gjyqtarit

32. Në funksion të kristalizimit të detyrimeve të sanksionuara nga dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të aplikueshme prej momentit të futjes së këtij të fundit në fuqi, vlen të qartësohet paraprakisht fakti që neni 179/b i Aneksit të Kushtetutës, në përcaktimin e subjekteve që i nënshtrohen *ex officio* procesit të rivlerësimit, përfshin të gjithë gjyqtarët dhe kategoritë e tjera, pa bërë asnjë specifikim, ndarje në nënkategori apo dallim midis gjyqtarëve në detyrë dhe atyre jo në detyrë. Për sa kohë ky përkufizim i përfshin të gjithë gjyqtarët që gëzojnë këtë status - ndryshe nga sa pretendon subjekti, Komisioni nuk konstaton arsye për të cilat znj. Shpresa Beçaj nuk do të duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.
33. Për më tepër që, edhe nga një këndvështrim më i gjerë, duke pasur parasysh frymën e dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, që synojnë rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve – dhe jo vetëm – duke përfshirë edhe ata të cilët kanë pasur më herët një të kaluar profesionale si gjyqtarë, prokurorë apo këshilltarë ligjorë (ish...), dhe aspirojnë të rikthehen si aktorë në sistemin e drejtësisë, ndonëse ndërkohë e kanë humbur statusin e mëparshëm, përforcohet bindja se znj. Shpresa Beçaj përfshihet ndër subjektet *ex officio*, të parashikuara nga pika 4 e nenit 179/b. Në të kundërt nuk mund të konsiderohet në harmoni dhe në përputhje me këto dispozita dhe as në funksion të realizimit të qëllimit të reformës në drejtësi, moskryerja e procesit të rivlerësimit ndaj një gjyqtari që jo vetëm ka mbuluar funksione të rëndësishme në karrierë, por edhe gjatë mosushtrimit të funksionit është ndierë gjithmonë (siç është shprehur vetë subjekti) dhe është trajtuar në vijimësi dhe pa ndërprerje si një pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë, konform dhe në sajë të të drejtave dhe efekteve që kanë buruar pikërisht nga statusi i gjyqtarit/magjistratit. Alternativa e anashkalimit të procesit të rivlerësimit - siç pretendon subjekti - jo vetëm që do të binte ndesh me frymën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore në fjalë, por do të rezultonte totalisht e pambështetur në ligj dhe në prova, si dhe me mangësi të argumenteve analitiko-juridike bindëse.
34. Duke u rikthyer te detyrimet e përcaktuara në ngarkim të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, në funksion të mundësisë të kryerjes, pikërisht, të këtij procesi ndaj tyre, citohen në mënyrë të shkurtuar dispozitat e mëposhtme:
 - a- Ligji nr. 84/2016 lidhur me fillimin e procedurës së vlerësimit të pasurisë, në pikën 1, të nenit 31 parashikon: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së*”.
 - b- Po ashtu, në pikën 1 të nenit 35, të po këtij ligji, lidhur me fillimin e procedurës për kontrollin e figurës, përcaktohet se: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për*

kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar”.

c- Ndërsa, në vijim, lidhur me fillimin e procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale, në pikën 1 të nenit 41 shprehet se: *“Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale”.*

35. Trupi gjykues rithekson se duke mbajtur në vëmendje edhe arsyetimin e bërë në dy pikat e para të këtij paragrafi (32 dhe 33), vlerëson se znj. Shpresa Beçaj, në momentin e futjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte një subjekt që duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*, për shkak të statusit që gëzonte dhe, për rrjedhojë, mbartte edhe detyrimin ligjor të përcaktuar në nenet e mësipërme, për paraqitjen e deklaratës së pasurisë, të deklaratës për kontrollin e figurës dhe formularin e vetëvlerësimit profesional, brenda afatit 30-ditor, nga hyrja në fuqi e tij.

Lidhur me shkaqet e mospërmbushjes së detyrimeve ligjore dhe pasojat që rrjedhin

36. Siç u përmend edhe më sipër, znj. Shpresa Beçaj nuk e ka përmbushur asnjëherë prej detyrimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me paraqitjen e dy deklaratave dhe të formularit të sipërcituar. Ky fakt është konfirmuar fillimisht nga institucionet përkatëse dhe më pas është pranuar edhe nga subjekti, e cila ka shpjeguar arsyet e mosparaqitjes së tyre në shpjegimet e përshkruara në pjesën e parë të këtij vendimi (pika 8).

37. Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, nuk ka kryer një vlerësim të saktë dhe të bazuar në dispozitat ligjore përkatëse kur ka konkluduar se nuk kishte detyrimin ligjor për të paraqitur deklaratat dhe formularin në fjalë. Pretendimi i subjektit se në prezencën e dyshimeve lidhur me interpretimin e saktë ligjor ishte paraqitur personalisht pranë institucionit të ILDKPKI-së [...] *për plotësimin dhe dorëzimin e tre formularëve sipas ligjit [...]*, por pasi kishte komunikuar me funksionarët përkatës i ish-in përgjigjur se *nuk mund të plotësonte këto deklaratat, pasi nuk gjendej e cituar në listat e organikave të gjykatave*, nuk duket bindës dhe nuk qëndron, për sa vijon:

a- Kjo rrethanë e pretenduar nga subjekti mbetet në nivel deklarativ dhe nuk është paraqitur prej saj asnjë dokument ligjor mbështetës (procesverbal apo vërtetim/deklaratë e ILDKPKI-së), që mund të konfirmojë pohimet e subjektit.

b- Sipas dispozitave ligjore përkatëse, të përshkruara më lart, në ILDKPKI duhej/mund të dërgohej (dhe jo detyrimisht duhej të paraqitej personalisht/dorazi), vetëm deklarata e pasurisë, për sa kohë deklarata për kontrollin e figurës dhe formulari për vetëvlerësimin profesional do të duhej të dërgoheshin pranë dy institucioneve krejt të ndryshme nga ILDKPKI-ja, konkretisht, në DSIK dhe KLD. Gjithashtu, rezultoi se deklaratat dhe formularët mund të shkarkoheshin edhe nga faqet zyrtare të këtyre institucioneve ose të tërhiqeshin pranë tyre dhe pasi të ishin plotësuar, mund të

përcilleshin drejt organeve marrëse edhe në rrugë elektronike apo me postë, duke përbushur në këtë mënyrë detyrimet ligjore të përshkruara më sipër.

- c- Gjithashtu, Komisioni çmon se interpretimi ligjor lidhur me përbajtjen, frymën dhe qëllimin e ligjit nr. 84/2016, si dhe me statusin specifik të znj. Shpresa Beçaj dhe mbi detyrimet që mbartte në sajë të këtij statusi, mund të vlerësoheshin më së miri dhe në mënyrë të saktë, prej saj, për sa kohë statusi dhe eksperiencia ia mundësonin.
 - d- Nuk rezultojnë të jetë bërë ndonjë tentativë për dërgimin/paraqitjen, apo së paku për kërkesë informacioni në rrugë zyrtare, lidhur me deklaratën për kontrollin e figurës dhe me formularin për vetëvlerësimin profesional.
38. Shpjegimet dhe pretendimet e znj. Beçaj nuk përmbajnë asnjë rrethanë apo fakt konkret të provuar, që mund të përbëjë ndonjë shkak ligjor justifikues për mospërbushjen e detyrimeve të analizuara më sipër. Gjithashtu, përpos tipologjisë së afateve, nuk ka rezultuar që subjekti në fjalë të ketë kërkuar ndonjëherë pranë institucioneve përkatëse apo pranë Komisionit rivendosjen në afat për shkaqe të arsyeshme, apo fuqi madhore, që nuk do t'i kishte mundësuar asaj, respektimin e afateve të përcaktuara nga ligji nr. 84/2016, përtej vlerësimit faktik, interpretimit ligjor dhe vullnetit të saj.
39. Nisur nga sa më lart, Komisioni duhet të mbajë në vëmendje përbajtjen e dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe konkretisht pikën 5, të nenit D që sanksionon: “*Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. [...]*”, si dhe në pikën 4 të nenit DH, sipas të cilit: “*Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet. [...]*”, të cilat rezultojnë detyrimisht të aplikueshme në çështjen në fjalë. Veç të tjerash rezultojnë se roli, vlefshmëria juridike dhe korrektesia e këtyre normave në harmoni me frymën e reformës në drejtësi është analizuar, argumentuar dhe konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese përgjatë shqyrtimit të çështjes së përfunduar me vendimin nr. 2/2017 (p. 46 dhe 47).
40. Së fundmi, një specifikim kalimthi (*obiter dictum*): Edhe nëse znj. Shpresa Beçaj do të kishte qenë një ish-gjyqtare, atëherë do të duhej të kishte paraqitur një kërkesë në zbatim të pjesës së dytë të pikës 4, të nenit 179/b në kohën dhe mënyrën e parashikuar, për t’iu nënshtruar vullnetarisht procesit të rivlerësimit, veprim të cilin nuk rezultojnë që ta ketë kryer.
41. Në konkluzion, trupi gjykues, në vijim të analizës së gjendjes faktike dhe ligjore të rezultuar në rastin konkret, si dhe të shpjegimeve të subjektit, çmon se duhet aplikuar masa e parashikuar në dy dispozitat e rangut kushtetues, të lartpërmendura, për sa kohë rrethanat dhe faktet e provuara nuk mundësojnë asnjë zgjidhje alternative të bazuar.
42. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që zotëron në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998,

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve: 31, 35 dhe 41, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Shpresa Beçaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.7.2020.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland ILIA
Kryesues

Lulzim HAMITAJ
Relator

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka